

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike	Fakulteti i Menaxhmentit
Programi	Menaxhimi i Biznesit dhe Ndërmarrësia
Titulli i lëndës	Menaxhimi Strategjik
Niveli	Bachelor
Statusi i lëndës	Obligative
Viti i studimeve	III
Semestri	V
Numri orëve në javë	3
Vlera në kredi - ECTS	5
Koha / lokacioni	USHAF
Mësimdhënësi i lëndës	
Detajet kontaktuese	
Përshkrimi i lëndës	Lënda ofron kuptimin dhe rëndësinë e menaxhimit strategjik në jetën e një ndërmarrje dhe organizate. Literatura shkencore është adekuate për studentet përmes temave - Kuptimi i termave kyçe në menaxhimin strategjik dhe modelin strategjik të menaxhimit, Kuptimi i rëndësisë së Vizionit dhe Misionit, Vlerësimi i Ambientit të Jashtëm, Strategjitë e integritetit; strategji intensive; strategjitë e diversifikimit; strategjitë mbrojtëse, Analizimi dhe Zgjedhja e Strategjisë, Kuptimi i çështjeve aktuale të marketingut - segmentimi i tregut dhe pozicionimi i produktit, Gjenerimi i ideve të reja të biznesit dhe modeleve të biznesit, Etika e biznesit, Përgjegjësia Sociale, Qëndrueshmëria Mjedisore. Organizatat multinacionale; avantazhet dhe disavantazhet e operacioneve ndërkombëtare; sfidat globale,
Qëllimet e lëndës	Nëpërmjet kësaj lende synohet që studenti të prekë hap pas hapi të gjitha stadet e menaxhimit strategjik që e bëjnë një organizatë efektive. Studenti duhet të ambientohet me situatat e ndryshme me të cilat përballet një manaxher strategjik të cilat duhet të finalizohen në marrjen e vendimeve dhe të realizojë qëllimin e çdo biznesi: arritjen e avantazhit konkurrues të qëndrueshëm në treg.
Rezultatet e pritura të	Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët do të

mësimnxënies	<p>jenë në gjendje të :</p> <ul style="list-style-type: none"> • përfitojnë njohuri baze për menaxhimin strategjik ne ndërmarrje, • vlerësojnë pozicionin strategjik të një organizate, • zhvillojnë alternativa strategjike dhe të komunikojnë ri pozicionimin strategjik të ardhshëm. • të marrin vendime strategjike ne grup dhe t'i arsyetojnë ato vendime përmes komunikimit me gojë dhe me shkrim. • demonstrojnë që kanë kuptuar se si vendimet strategjike mund të zbatohen me sukses. • marrin vendime strategjike ne grup dhe mbrojnë strategji specifike që ata i përcaktojnë si më të mirat, bazuar në mjetet dhe konceptet në këtë lëndë. • zbatojnë konceptet dhe mjetet strategjike ne ekipe duke rekomanduar strategji që janë më të përshtatshme për organizatat që studiojnë. • kompetent për te qene pjese te ekipes ku formulojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë strategjitë e ndërmarrjes.
---------------------	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrimet teorike/detyra	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësit - konsultimet	1	5	5
Ushtrime në terren	5	1	5
Kollokuiume - seminare			
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)			45
Përgatitja përfundimtare në provim	2	5	10
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	2	2	4
Projektet, prezantimet etj	1	6	6
Totali			125

Metodologjia e mësimit (dhe mësuesit)	Lënda zhvillohet në 15 javë me ngarkesë 2 orë ligjerata në të cilat do të trajtohen konceptet teorike dhe do të ipen sqarime lidhur me procesin e menaxhmentit strategjik të ndërmarrjeve, si dhe dhe 1 orë ushtrime në grupe në javë . Ushtrimet do të zhvillohen në formë me grupe në të cilat do të diskutohen shembuj konkret. Kjo mënyrë e organizimit të ushtrimeve do t'ju shërbejë studentëve për të përvetësuar në mënyrë logjike konceptet teorike dhe për ta lidhur në mënyrë organike teorinë me aspektet praktike të aktivitetit të biznesit. Studentët do të nënshtrohen një provimi kontrolli gjatë vitit (punim seminarik të rastit studimor) dhe një provimi përfundimtar në mbarim të ciklit të plotë të kësaj lënde.
Metodat e vlerësimit (kriteret e kalueshmërisë)	Metoda (Kriteret) e vlerësimit: <ul style="list-style-type: none"> • 10 pike - angazhimi në ligjerata dhe vijueshmëria, • 40 pikë - punim seminarik, rasti studimor, • 50 pike - provimi final, Testi i Provimit (test me shkrim/gojë) - përmban pyetje të ndryshme me shumë zgjedhje dhe pyetje të hapura, Studenti e kalon provimin nëse grumbullon 50 pike nga të gjitha kriteret e vlerësimit,
Mjetet e konkretizimit - TI	Përdorimi i tabelës, Interneti, wireless, kompjuteri, projektori, PowerPoint, etj.
Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike të studimit	70% - Teori, 30% - Ushtrime praktike,
Literatura	
Literatura bazë	1. Vasilika Kume "Manaxhimi Strategjik" 2007 2. Fred David - "Strategic Management" 2010
Literatura shtesë	1. Johnson, Whittignton & Scholes, "Exploring Strategy". 9th Edition 2011. Pearson Education 2. Grup autoresh - "Menaxhmenti Strategjik" 2008
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë	Natyra e Menaxhimit Strategjik Kuptimi i menaxhimit strategjik të ndërmarrjes, kuptimi i termave kyçe në menaxhimin strategjik dhe modelin strategjik të menaxhimit.

Java e dytë	Vizioni dhe Misioni i Biznesit Kuptimi i rëndësisë së Vizionit dhe Misionit; çfarë është puna jonë dhe çfarë duam të bëhemi; karakteristikat e vizionit dhe deklaratave të misionit; shkrimi dhe vlerësimi i deklaratave të misionit.
Java e tretë	Vlerësimi i Ambientit të Jashtëm Kuptimi i ndikimit të forcave mjedisore sociale, kulturore, demografike dhe natyrore; forcat politike, qeveritare dhe juridike; forcat teknologjike; forcat konkurruese; analiza konkurruese: modeli i pesë forcave të Porterit; analiza e industrisë; dhe matrica e profilit konkurrues.
Java e katërt	Vlerësimi i Ambientit të Brendshëm Këndvështrimi i bazuar në burime; integrimi i strategjisë dhe kulturës; të kuptuarit e funksioneve kryesore të biznesit si marketingu, financat/kontabiliteti, prodhimi/operacionet, kërkimi dhe zhvillimi; Menaxhimi i Sistemeve të Informacionit; analiza e zinxhirit të vlerës; dhe vlerësimi i faktorëve tjerë të brendshëm.
Java e pestë	Strategjitë në Veprim Formulimi i objektivave afatgjata; të kuptuarit e llojeve të strategjive: strategjitë e integritit; strategji intensive; strategjitë e diversifikimit; strategjitë mbrojtëse; strategjitë gjenerike të Porterit; menaxhim strategjik në organizata jofitimprurëse dhe qeveritare; dhe menaxhimi strategjik në ndërmarrje.
Java e gjashtë	Analizimi dhe Zgjedhja e Strategjisë Kuptimi i natyrës së analizës dhe zgjedhjes së strategjisë; kuptimi i një kornize gjithëpërfshirëse të formulimit të strategjisë; aspektet kulturore të zgjedhjes së strategjisë; politika e zgjedhjes së strategjisë; dhe çështjet e ndryshme të qeverisjes.
Java e shtatë	Strategjitë Zbatuese: Çështjet e Menaxhimit dhe Operacioneve Kuptimi i natyrës së zbatimit të strategjisë; hartimi i politikave; alokimi i burimeve; përputhja e strukturës me strategjinë; ristrukturimi dhe riinxhinierimi; lidhja e performancës dhe pagës me strategjitë; menaxhimi i rezistencës ndaj ndryshimit; dhe krijimi i një kulture mbështetëse të strategjisë.
Java e tetë	Strategjitë Zbatuese: Marketingu, Financat/Kontabilitet, R&D dhe Çështjet MIS Kuptimi i çështjeve aktuale të marketingut - segmentimi

	i tregut dhe pozicionimi i produktit; të kuptuarit e çështjeve të financave/kontabilitetit - blerja e kapitalit për zbatimin e strategjive; çështjet e kërkimit dhe zhvillimit (R&D); çështjet e sistemeve të informacionit të menaxhimit (MIS).
Java e nëntë	Inovacioni dhe Ndërmarrësia Hyrje në inovacion fokusohet në shtytjen e teknologjisë dhe nevojën për inovacion të produktit; gjenerimi i ideve të reja të biznesit dhe modeleve të biznesit dhe modeleve të hapura të biznesit; rritja e sipërmarrjes dhe marrëdhëniet.
Java e dhjetë	Vizitë studimore / ligjërues vizitor të ftuar nga partnerë të industrisë
Java e njëmbëdhjetë	Rishikimi, Vlerësimi dhe Kontrolli i Strategjisë Një kornizë e vlerësimit të strategjisë; karakteristikat e një sistemi efektiv të vlerësimit; planifikimin e rasteve; auditimi; sfidat e shekullit XXI në menaxhimin strategjik.
Java e dymbëdhjetë	Etika e biznesit / Përgjegjësia Sociale / Qëndrueshmëria Mjedisore Etika e Biznesit; Përgjegjësia sociale; dhe Qëndrueshmëria mjedisore.
Java e trembëdhjetë	Çështjet globale/ndërkombëtare Organizatrat multinacionale; avantazhet dhe disavantazhet e operacioneve ndërkombëtare; sfidat globale, etj.
Java e katërbëdhjetë	Si t'a përgatisim dhe t'a paraqesim një analizë të rastit studimor Çfarë është një rast i menaxhimit strategjik; përgatitja e një rasti për diskutim në klasë; përgatitjen e një analize të rastit me shkrim, etj.
Java e pesëmbëdhjetë	Pregaditja e një prezantimi oral Organizimi i prezantimit; kontrollimi i zërit; menaxhimi i gjuhës së trupit; ndërtimi i mjeteve vizuale; përgjigjja e pyetjeve; përmbledhja e analizës së rastit të studimit.
Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes	
Studenti është i obliguar t'i vijojë ligjëratat më rregull dhe të ketë sjellje korrekte ndaj kolegëve dhe stafit të Universitetit, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi interaktiv gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.	